



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT BERAT

Nr. 572/19 Prot

Datë 30/06/2025

V E N D I M

Nr. 6

Datë 27/06/2025

**MBI MIRATIMIN E PROJEKTDOKUMENTIT TË PARË TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2026-2028**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 97/2023, “Për Buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2 date 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 28.02.2025, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026–2028”; Këshilli i Qarkut Berat:

V E N D O S I:

1. Të miratojë projekt dokumentin e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të Këshillit të Qarkut Berat të përgatitur sipas Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor.
2. Të miratojë relacionin shpjegues për procesin e përgatitjes së projekt dokumentit të parë të PBA 2026-2028
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i Financës Zhvillimit Rajonal e Investimeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimit të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, i ndryshuar, neni 78, pika 3.

KRYETAR
Donald MOLISHTI

Këshilltarë gjithsej	<u>18</u>
Morën pjesë	<u>12</u>
Votuan Pro	<u>12</u>
Votuan Kundër	<u>-</u>
Abstenim	<u>-</u>